



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 1

Prishtinë, më 9.10. 2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mosilović, zëvendëskryetar i dytë, Xhelal Sveçla, Drita Millaku, Ismet Beqiri, Fadil Beka, Blerim Kuçi dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Munguan: Ramiz Kelmendi e Fatmir Xhelili.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala, kryetar i Komisionit.

Kryetari i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

Konstituimi i Komisionit

Haxhi Shala, kryetar, fillimisht theksoi që qëllimi i këtij takimi është njohja mes anëtarëve të Komisionit, duke uruar që puna e Komisionit të mos reflektojë përbërjen politike, pasi siguria është çështje për interesin e vendit.

Sipas vendimit të seancës plenare të datës 3 tetor 2017, Komisioni ka këtë përbërje: Haxhi Shala, kryetar (G/P – NISMA), Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë (G/P - VV), Zoran Mojsilović, zëvendëskryetar i dytë (G/P – LS), Xhelal Sveçla, anëtar (G/P - VV), Drita Millaku, anëtare (G/P – VV), Ismet Beqiri, anëtar (G/P - LDK), Ramiz Kelmendi, anëtar (G/P - LDK), Fatmir Xhelili, anëtar (G/P - PDK), Fadil Beka, anëtar (G/P - PDK), Blerim Kuçi, anëtar (G/P – AAK) dhe Bahrim Shabani, anëtar (G/P - 6+).

Shala njoftoi për fushëveprimtarinë e Komisionit me fokus për dy fushat kryesore, të cilat i ushtron në cilësinë e Komisionit Funkcional. Komisioni shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me miratimin dhe amendamentimin e legjislacionit për fushën e sigurisë. Përveç legjislacionit komisioni shqyrton edhe dokumentet strategjike që lidhen me këtë fushe. Gjithashtu ushtron kontrollin dhe mbikëqyrjen demokratike ndaj institucioneve të sigurisë. Duke mbikëqyrë zbatimin e ligjeve, duke ftuar në seanca dëgjimore dhe dëgjime publike ministrat përkatës dhe stafin drejtues. Mbikëqyrjen e shpenzimeve buxhetore, vizita në ministri apo në terren, sidomos vendndodhjen e njësive të Policisë së dhe FSK-së dhe aspekte tjera.

Shala theksoi edhe mbështetjen që i është dhënë Komisionit nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare, si OSBE-ja, DCAF(Qendra për Siguri, Zhvillim dhe Sundim të Ligjit), GIZ-i, UNDP-ja, ndërsa sa i përket ditës së mbajtjes së mbledhjes propozoi ditën e hënë.

PËRFUNDIM

Pas konsultimeve mes anëtarëve të Komisionit, u vendos që dita e martë, ora 10:00, të jetë dita e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Komisionit, ndërsa sipas nevojës, mbledhjet mund të thirren edhe ditëve të tjera.

Blerim Kuçi, lidhur me planin e punës së Komisionit, tha se do të ishte mirë të shikohen prioritetet kohore për të trajtuar çështjet e rëndësishme.

Haxhi Shala, kryetar, njoftoi anëtarët e Komisionit për takimin e realizuar me znj. Antje Fritz (Zëvendësshef i Operacioneve në Evropën Juglindore-DCAF), me të cilën është diskutuar për organizimin e një tryezë të përbashkët mes dy komisioneve (Komisionit për Siguri dhe Komisionit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë), përfaqësuesit e FSK-së. Datat e propozuara janë në mes 6 deri 9 nëntor 2017 dhe kërkoi miratimin nga ana e anëtarëve të Komisionit për këtë datë.

Rexhep Selimi, theksoi se relacioni i Komisionit me DCAF-in është specifik, pasi ka mbështetur në vazhdimësi Komisionin, ka mbështetur edhe gjatë procedimit të ligjeve dhe e vlerësoi gatishmërinë e znj. Fritz për këtë bashkëpunim.

PËRFUNDIM

Kryetari konstatoi që të gjithë anëtarët e pranishëm u pajtuan për mbajtjen e tryezës e mbështetur nga DCAF-i, sipas datës së propozuar, nga 6-9 nëntor 2017.

Kryetari, njoftoi edhe për planin legjislativ të dërguar nga Qeveria, i cili është për tremujorin e mbetur të vitit 2017, duke e vlerësuar të nevojshëm hartimin e një plani të veprimit për këtë tremujor, ku do të përcaktohen dhe vizitat në ministritë e linjës dhe agjencitë e pavarura, që janë në fushëveprimin e Komisionit.

Rexhep Selimi, theksoi se mbështet këtë propozim, për hartimin e një plani të veprimit dhe se prioritet duhet të ketë agjenda legjislative, plani i cili do të jetë në hap me sponsorët dhe ministritë përkatëse.

Blerim Kuçi, kërkoi që të përgatitet një informatë, ku do të pasqyrohen aktivitetet e bashkëpunimit me organizatat mbështetëse, sidomos me organizatat ndërkombëtare (DCAF, OSBE), por edhe ato vendore dhe kërkoi të merren parasysh aktivitete që kanë prioritet në këtë

kohë, për të vazhduar punën e Komisionit, duke vlerësuar që Komisioni paraprak ka bërë një punë të mirë.

Drita Millaku, kërkoi që materialet e mbledhjes të përcillen përmes e-mailit nga ana e stafit.

Kryetari, në mbledhjen e radhës propozoi që të prezantohet plani i veprimit për tre muajt e ardhshëm dhe të ftohet ndonjëri nga ministrat e linjës në takim njoftues në Komision.

PËRFUNDIM

Kryetari konstatoi që Komisioni është dakord që në mbledhjen e radhës së Komisionit, të ftohet në takim njoftues me Komisionin z.Flamur Sefaj, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Haxhi Shala